



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1087/prot.
2

Tiranë më 11.9.2017

VENDIM

Nr. 86, datë 11.9.2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) formularin e Ankesës nr. 1087 Prot., datë 08.08.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me shkresën e datës 07.07.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

1. *Kontratën e qerasë që Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka lidhur me subjektin privat, i cili ushtron aktivitetin bar-kafe në ambientet e saj.*

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 5318/1 Prot., datë 20.07.2017 duke e drejtuar këtë të fundit pranë MZHETTS si autoriteti kompetent për dhënie të këtij informacioni, në cilësinë e qiradhënësit, mbështetur në Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 6756, datë 03.09.2015 i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1087 Prot., datë 08.08.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1087/1 Prot, datë 21.08.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni.

Në tejkallim të çdo afati të përcaktuar në ligjin për të drejtën e informimit, Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Z. , përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloji forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Në bazë të pikës 2, të nenit 3 të Ligjit të sipërcituar, Autoriteti Publik detyrohet të informojë kërkuuesin nëse e ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

Në rastin kur Autoriteti Publik konstaton se nuk e disponon informacionin e kërkuar, bazuar në pikën 2 të nenit 12, të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, *ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.*

Pra, Autoriteti Publik, nëse nuk e zotëron informacionin e kërkuar, duhej të kishte proceduar ai vetë me përcjelljen e kërkesës pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes duke vënë në dijeni për këtë fakt dhe kërkuuesin, dhe jo të adresonte këtë fundit për t’iu drejtuar me kërkesë të posaçme MZHETTS. Ndërsa, nëse informacioni i kërkuar zotërohet nga autoriteti publik ai duhej të vihej në dispozicion të kërkuuesit. Mosvënia në dispozicion e informacionit të kërkuar përbën shkelje të ligjit për të drejtën e informimit.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Z. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Z. Nr. 1087 Prot., datë 08.08.2017, kundër Autoritetit Publik "Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kontrata e qerasë që Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka lidhur me subjektin privat, i cili ushtron aktivitetin bar-kafe në ambjentet e saj), brenda datës 18. 9 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 11. 9 .2017.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

